VENDIM
Nr.601, datë 16.12.1999

PËR MIRATIMIN NË PARIM TË MARRËVESHJES MBI PROJEKTIN "ARSIMI NDËRKULTUROR DHE EDUKIMI ME TË DREJTAT E NJERIUT NË SHQIPËRI" MIDIS QEVERISË SË SHQIPËRISË DHE UNESCO-S

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin në parim, të marrëveshjes për projektin, "Arsimi ndërkulturor dhe edukimi me të drejtat e njeriut në Shqipëri", midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe UNESCO-s.

2.Neni 8, pika 1 e marrëveshjes ndryshon si më poshtë:

"Kjo marrëveshje hyn në fuqi me ratifikimin e saj nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta